UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE

QEVERIA E KOSOVËS

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

STRATEGJIA PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË

KOMPONENTA E EDUKIMIT 2007-2017

Prishtinë, korrik 2007

UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE

QEVERIA E KOSOVËS

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

STRATEGJIA PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË

KOMPONENTA E EDUKIMIT 2007-2017

Prishtinë, korrik 2007

Përmbajtja

Lista e shkurtesave 4
Përmbledhje ekzekutive 7
1. Hyrje 9
2. Gjendja e tanishme e arsimit të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian 14
Integrimi i pjesshëm i komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në arsim 15
Pjesëmarrje jo e kënaqshme e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në arsim 15
3. Vizioni dhe Misioni 17
Vizioni 17
Misioni 18
4. Objektivat strategjike 19
4.1. Përmirësim domethënës i pjesëmarrjes në arsim dhe i cilësisë së arsimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 20
4.2. Parandalimi i diskriminimit dhe segregacionit në sistemin e arsimit 25
4.3. Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes organizatave dhe institucioneve relevante 27
4. 4. Ndërgjegjësimi dhe gatishmëria e faktorëve relevant për të ndihmuar në proceset edukativo-arsimore 32
5. **Plani zbatimit të Strategjisë** 35
6. **Buxheti i Strategjisë** 57
SHTOJCË: Lista e pjesëmarrësve 61

Lista e shkurtesave

Shkurtesa	Emri i plotë
AER	Agjencioni Evropian për Rikonstruktim
AGEF	ArbeitsGruppe Entwicklung und Fachkraefte im Bereich der Migration und der Entwicklungszusamenarbeit
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
CCFD	Comitè Catholique Contre la Fair et Pour le Dèveloppement
CRS	Shërbimet Katolike për Ndihmë
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
ECHO	Organizata Humanitare e Bashkimit Evropian
EFA	Arsimimi për të Gjithë
FSDEK	Programi Finlandez për Mbështetjen e Arsimit Special në Kosovë
GTZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INALCO	Fakulteti i gjuhëve orientale dhe i romologjisë në Sorbonë
IOM	Organizata Internacionale për Migrim
IP	Instituti Pedagogjik
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
KOSVET	Programi kosovar për trajnim dhe edukim profesional
KPA	Këshilli Prind Arsimtar
KPAK	Këshilli i Prindërve dhe i Arsimtarëve të Kosovës
KRAF	Forumi i Kosovës për Rom, Ashkali dhe Egjiptian
KSH	Këshilli i Shkollës
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MKRS	Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale

MRGI	Grupi Internacional për të Drejtat e Minoriteteve
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Komunitetit
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuar për Zhvillim
ZK	Zyra e Kryeministrit
ZKK	Zyra Komunale për Komunitete
ZRA	Zyra Rajonale e Arsimit

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim është njëra ndër komponentat e një strategjie gjithëpërfshirëse për integrimin e këtyre komuniteteve në Kosovë, e cila është duke e hartuar nën mbikëqyrjen e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. , Hartimi i strategjisë në fushën e arsimit është sponsoruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Vet procesi i hartimit të kësaj komponenteje është zhvilluar në koordinimin e Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) dhe është karakterizuar me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes: Qeverisë, përfaqësuesve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, shoqërisë civile, partive politike, organizatave ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut dhe të fëmijës (OSBE dhe UNICEF), etj., si dhe me përpjekje të vazhdueshme për të arritur konsensus për të gjitha çështjet kyçe.

Zhvillimi i këtij dokumenti është ndikuar shumë nga fakti se Qeveria e Kosovës ka Strategji të Zhvillimit Parauniversitar për periudhën 2007-2017 dhe Strategji të Arsimit të Lartë për periudhën 2005-2015. Të dy dokumentet e vejnë theksin në gjithëpërfshirje përmes ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë, prandaj edhe ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në arsim. Sistemi i objektivave të kësaj Strategjie është dhënë në vijim:

Vizioni: *Kosova – shoqëri e dijes dhe gjithëpërfshirëse, me respekt për diversitetin, e integruar në rrjedha evropiane, me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilit i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror*.

Misioni: *Ndërtimi i sistemit arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës, të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin, që i kontribuon integrimit të plotë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqëri.*

Objektivat strategjike:

1. Përmirësim domethënës i pjesëmarrjes në arsim dhe i cilësisë së arsimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

2. Parandalimi i diskriminimit dhe segregacionit në sistemin e arsimit

3. Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes institucioneve dhe organizatave relevante në funksion të arsimimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjipian

4. Ndërgjegjësimi i komuniteteve dhe palëve me interes për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Në planin strategjik janë paraparë 25 masa të përgjithshme të cilat mund të konkretizohen në dhjetëra projekte për të realizuar transformimin e nevojshëm nga gjendja e konstatuar në fillim të procesit deri te përmbushja e misionit të Strategjisë.

Kalkulimet buxhetore për periudhën 2007-2012 janë të detajuara dhe reflektojnë konsensusin e pjesëmarrësve në procesin e hartimit të Strategjisë. Këto kalkulime janë bërë për çdo masë veç e veç, ndërsa janë përmbledhur sipas objektivave strategjike dhe si tërësi.

1. Hyrje

Kjo komponentë e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, ka për qëllim të identifikojë dhe mobilizojë të gjitha burimet relevante që lidhen me sistemin arsimor të të gjitha niveleve, për të kontribuar në përmirësimin e shkallës së arsimimit dhe fuqizimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në Kosovë, me synim për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Qeveria e Kosovës, duke parë vështirësitë me të cilat përballen pjesëtarët e të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian u angazhua për hartimin e një Strategjie gjithëpërfshirëse për përmirësimin e pozitës së tyre në të gjitha fushat. Strategjia parasheh disenjimin dhe implementimin e politikave dhe programeve konkrete për zbutjen e varfërisë, përfshirjen e tyre në jetën publike, përfshirjen në sistemin e arsimit, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre etnik dhe kulturor. Komunitetet rom, ashkali, egjiptian dhe faktorët tjerë ndërkombëtarë janë partnerë të fuqishëm dhe bashkëpunues të Qeverisë së Kosovës për hartimin dhe zbatimin e këtij dokumenti të rëndësishëm.

Ministria e Arsimit ka hartuar strategjinë dhjetëvjeçare, e cila u miratua nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2007, në kuadër të së cilës janë paraparë masa dhe aktivitet që adresojnë problemet dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen të gjitha komunitetet. Komponenta e arsimit të strategjisë rom, ashkali, egjiptian përplotëson në përgjithësi strategjinë e Arsimit Parauniversitar të Kosovës, dhe në veçanti masat që kanë të bëjnë me arsimin e grupeve të pafavorizuara, promovimin e diversitetit, barazisë, dhe përfshirjes në arsim. Me aprovimin e kësaj komponente MASHT do të jetë bartës kryesor i zbatimit të këtij dokumenti strategjik, në partneritet me palët tjera të interesit.

Hartimi i Strategjisë së Qeverisë së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në Kosovë ka filluar në qershor të vitit 2006 me përkrahjen e OSBE dhe KFOS. Fillimisht, është organizuar një punëtori me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes, përfshirë edhe përfaqësuesit e të tri komuniteteve nga të gjitha viset e Kosovës. Në këtë punëtori janë identifikuar fushat problemore që duhet

adresuar me strategji, njëra prej të cilave është **arsimi.** Gjithashtu, është bërë një analizë gjithëpërfshirëse e problemeve sipas fushave.

Për fushën e arsimit është formuar një grupi i veçantë punës me pjesëmarrës nga struktura të ndryshme: Qeveria, partitë politike, KRAEF dhe organizatat relevante nga shoqëria civile, partitë politike etj. Ky grup ka rishikuar edhe një herë rezultatet e punëtorisë së parë, duke definuar në mënyrë eksplicite: sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet që lidhen me integrimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në Kosovë në fushën e arsimit.

Strategjia për integrimin e komunitetit rom, ashkali, egjiptian në Kosovë në relacion me legjislacionin ndërkombëtar

Deklarata e KB-së për të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Nacionale apo Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, dokument i aprovuar në vitin 1992 thekson që "shtetet duhen t'i qasen të drejtave për edukim të komuniteteve në mënyrë proaktive. Kur kërkohet, masat e veçanta duhen të adaptohen nga Shteti që në mënyrë aktive të ushtrojë të drejtën për edukim të minoriteteve në maksimum të burimeve që ka në dispozicion, individualisht ose përmes asistencës ndërkombëtare dhe bashkëpunimit sidomos ekonomik dhe teknik". Dokumenti për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, si një minoritet në Kosovë, trajton këtë masë të përshkruar në këtë dokument të KB-së.

Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, të aprovuar qysh në vitin 1948, të drejtat e njeriut janë të bazuara në njohjen dhe pranimin e personit njerëzor në të gjithë diversitetin e tij. Të drejtat ndërkombëtare të njeriut, si jodiskriminimi, liria e shprehjes dhe religjionit si dhe të tjerat janë të gjitha të themeluara në njohjen e vlerës dhe dinjitetit njerëzor. Këto të drejta janë të bazuara në tolerancën e dallimeve njerëzore, sikur që janë dallimet religjioze ose gjuhësore. Mohimi i të drejtës së individëve për qasje në përfitime të caktuara, ose mos-favorizimi për arsye të religjionit ose gjuhës – nuk është më e pranueshme. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948 solli bazë të re meqë ishte instrumenti i parë ndërkombëtar i cili e deklaroi shkollimin si të drejtë të njeriut. Neni 26 i Deklaratës e definon shkollimin elementar si të obligueshëm. Ajo i obligon shtetet që teknikisht dhe profesionalisht t'a bëjnë të mundshëm shkollimin kurse arsimin e lartë t'a bëjë të kapshëm në bazë të meritës. Ai gjithashtu qartëson se qëllimi i shkollimit duhet të jetë

zhvillimi i plotë i personaliteteit njerëzor dhe forcimi i respektit për të drejtat e njeriut dhe lirive fundamentale. Neni 26 më tutje thotë se shkollimi promovon mirëkuptim, tolerancë dhe miqësi mes kombeve, grupeve racore ose fetare dhe kontribon për ruajtjen e paqës.

Nëse e shohim Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, dokumenti strategjik kosovar i referohet Nenit 14 ku deklarohet e drejta e pakicave për ruajtjen e identitetit të tyre kolektiv nëpërmjet gjuhës amtare. Kjo e drejtë realizohet nëpërmjet shkollimit. Këto instrumente e nënvizojnë faktin se e drejta për ruajtje të identitetit kolektiv nëpërmës gjuhës së pakicës duhet të ekuilibrohet me përgjegjësinë për integrim dhe pjesëmarrje.

Dokumenti kosovar, po ashtu, reflekton Nenin 27 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, ku u garantohet pakicave e drejta e përdorimit të gjuhës së tyre në bashkësi dhe me anëtarët tjerë të grupit të tyre.

Lidhur me diskriminimin, objektiva e veçantë në Strategjinë e Përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në Arsim trajton detajisht Nenin 5 të Konventës së UNESCO-s kundër Diskriminimit në Arsim, ku sigurohen garancitë rreth mundësive të pakicave kombëtare për të mësuar gjuhën e tyre amtare ose të mësojnë atë.

Objektivat e dokumentit kosovar u janë referuar edhe Konventës për të drejtat e Fëmijës, fillimisht Nenit 28, të drejtës në arsimim, por edhe Nenit 30, pra në ato shtete ku ekzistojnë minoritetet gjuhësorë, fëmija që i takon atij minoriteti nuk i mohohet e drejta e përdorimit të gjuhës.

Nga kjo nxjerret si premisë themelore e drejta në edukim në gjuhën minoritare. Të refuzohet sigurimi i edukimit publik në një gjuhë për minoritarët nuk mund të arsyetohet dhe konsiderohet veprim diskriminues. Por kjo nuk do të thotë që çdo kërkesë e paplotësuar e minoriteteve për edukimin në gjuhë specifike është automatikisht edhe shkelje e të drejtave të njeriut, pavarësisht kostos ose vështirësive praktike që mund të ngriten. Ekziston një kuptueshmëri se duhet të vendoset një balans mes interesave të përfshira: atyre të individëve potenciali edukativ i të cilëve mund të jetë i pafavorizuar me preferencat linguistike të qeverisë, dhe me interesat e

shtetit legjitim, ku shteti orvatet të sigurojë shërbime në gjuhën e minoritarëve por mund të jetë e kufizuar për arsye të mungesës burimeve njerëzore ose financiare.

Dokumenti për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian – komponenti i edukimit tregon që edukimi në gjuhën e minoriteteve është më tepër një pasuri se sa një detyrim kur kuptohet dhe aplikohet siç duhet. Nuk është një e drejtë që është e aplikueshme në secilën situatë ku një individ mund thjesht ta kërkojë si të drejtë individuale. Është më tepër rezultat që është në përputhje me respektimin e vlerave për diversitet dhe tolerancë të dallimeve, të cilat dhe janë gurthemel i shumicës së shoqërive demokratike.

Dokumenti strategjik kosovar adreson situatat e pafavorshme që mund t'i hasin fëmijët për të cilët gjuha zyrtare nuk është gjuha amtare. Kjo do të thotë se autoritetet publike sigurojnë përdorim të përshtatshëm të gjuhës minoritare si medium të mësimdhënies në shkollat publike sipas rrethanave.

Kjo padyshim zë fill si nga koncensusi në traktatet e mëvonshme dhe instrumenteve të tjera të Këshillit të Evropës, OSBE-së dhe institucioneve të Bashkësisë Evropiane që lidhen me minoritetet dhe edukimin në gjuhën e tyre. Të katër objektivat e dokumentit strategjik kosovar për komunitetet rom, ashkali, egjiptian mund të hasen në kuadër të normave të përcaktuara me dokumentet ligjore të BE-së.

Deri në janar të. v. 2007 Bashkësia Evropiane ka prodhuar një numër të konsiderueshëm të rezolutave për komunitetin rom (shtatë nga Parlamenti Evropian[1] dhe tre nga Këshilli i Bashkësisë Evropiane[2]), raporte të shkëlqyera Evropiane[3], dhe

1 Rezoluta e Parlamentit Evropian për Situatën e Romëve në Komunitet (1984); Rezoluta e Parlamentit Evropian Mbi Edukimin e Fëmijëve prindërit e të cilëve nuk kanë vendbanim të përhershëm (1984); Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi Analfabetizmin dhe Edukimin e fëmijëve prindërit e të cilëve nuk kanë vendbanim të përhershëm (1989); Rezoluta e Parlamentit Evropian për Romët në Komunitet (1994) ; Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi Diskriminimin kundër Romëve dhe Sintëve (1995); Rezoluta e Situatës së Romëve dhe Sintëve në Bashkësinë Evropiane (2005); Rezoluta mbi Situatën e femrave Rome dhe Sinti në Bashkësinë Evropiane (2006).

2 Rezoluta Nr. 89/C 153/02 e Këshillit të Bashkësisë Evropiane mbi dispozitat shkollore për fëmijët romë dhe ata udhëtarë (1989); Rezoluta e Këshillit dhe Ministrave të Edukimit përbrenda Këshillit për dispozitat shkollore për fëmijët udhëtarë të zënë me punë (1989) ; Rezoluta e Këshillit dhe përfaqësuesve ë vendeve anëtare; Takimeve Qeveritare përbrenda Këshillit mbi Gatishmërinë e Sistemeve të Edukimit për trajtimin e problemeve të Racizmit dhe Ksenofobisë (1995)

3 Përkrahja e BE-së për Komunitetin Rom (2002), Situata e romëve në një Evropë të zmadhuar (2004) Punësimi dhe Çështjet Shoqërore; Rishikimi i asistencës PHARE të Bashkësisë Evropiane për

që nga viti 1984 Këshilli i Evropës në Strasburg ka prodhuar më tepër se 500 dokumente që lidhen me komunitetin rom, gjegjësisht në përfshirjen e tyre në fusha të ndryshme shoqërore.

Në anën tjetër, Zyra e Komisarit të Lartë për Pakica Kombëtare pranë OSBE-së doli me dokumentin për Rekomandimet E Hagës Lidhur Me Të Drejtat E Shkollimit Të Pakicave Kombëtare. Sipas këtij dokumenti, shtetet janë inkurajuar t'u qasen të drejtave të njeriut në mënyrë proaktive, sipas frymës së nenit 31 të Dokumentit të Kopenhagës i cili inkurajon shtetet ta mbrojnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicave kombëtare. Dokumenti strategjik kosovar i qaset në mënyrë proaktive trajtimit të elementit gjuhësor dhe atij edukativ të Dokumentit të Hagës, me çka përmbushet edhe neni 33 i Dokumentit të Kopenhagës ku kërkohet që shtetet ta mbrojnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicave që jetojnë në territorin e tyre dhe të krijojnë kushte për promovimin e këtij identiteti.

minoritetet romë (2004) "Mbrojtja e minoriteteve në BE" nga Rrjeti i BE-së I ekspertëve të pavarur për të drejtat fundamentale (2004); Barazia dhe jo-diskriminimi – Raporti vjetor (kaptina e veçantë për "Përmirësimin e situatës së romëve në BE); Punësimi dhe Çështjet Shoqërore - Opinionet Kyçe 2005: Qasja në Drejtësi

2. Gjendja e tanishme e arsimit të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian

Komunitetet romë, ashkalinj dhe Egjiptian ballafaqohen me probleme te ndryshme lidhur me arsimimin, posaçërisht kur bëhet fjalë për integrimin e tyre në sistemin e arsimor. Vështirësitë fillojnë nga regjistrimi, zotërimi i gjuhës, pranimi nga komuniteti shumicë, disbalanci kulturor, social dhe ekonomik. Problemet dhe vështirësitë që i përcjellin këto komunitete janë të ngjashme me problemet që këto komunitete kanë në Evropën Juglindore. Megjithatë, zhvillimet në fillimin e viteve të 90-ta në Kosovë kanë lënë në pozitë edhe më të disfavorshme qasjen në arsim të këtyre komuniteteve. Kjo pozitë është vështirësuar edhe më tej si rezultat i luftës në Kosovë, ku si rezultat është bërë zhvendosja e popullatës brenda dhe jashtë Kosovë. Vlerësimet e përafërta nga KB tregojnë se pas konfliktit të vitit 1999, pjesëmarrja e rom, ashkali, egjiptian në popullatën e Kosovës ka pësuar rënie nga 100,000 në 35-40,000 pjesëtarë, gjë që ka ndikuar dukshëm edhe në përfshirjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në sistemin arsimor. Tetë vite pas konfliktit, arsimimi i komuniteteve rom, ashkali, egjiptian vazhdon të jetë i lidhur me statusin socio-ekonomik të tyre dhe dukuritë e margjinalizimit, diskriminimit dhe segregimit.

Sipas të dhënave të fundit nga Sistemi i Menaxhimit të Informatave për Arsimin (SMIA) të v. 2005/06, nga niveli parashkollor deri në nivelin e mesëm të lartë numri i fëmijëve të komunitetit rom, ashkali, egjiptian të përfshirë është 4527, ose 1.1 % karshi komunitetit shumicë, gjersa numri i personelit rom, ashkali, egjiptian të punësuar në arsim, sipas të dhënave të Ministrisë së Shërbimeve Publike të majit 2007 është gjithsej 140, ose 0.53 % karshi komunitetit shumicë.

Në një plan të përgjithshëm, nëse merren të dhënat nga Dekada e Romëve dhe krahasohen me vendet fqinje, numri i fëmijëve që kanë përfunduar nivelin e mesëm të lartë është 4.5 %, gjersa në Shqipëri 4.3 %, në Serbi 9 %, në Maqedoni 11.6 % dhe në Mal të Zi është 3.7 %.

Zbatimi i këtij dokumenti do të mobilizojë të gjitha strukturat relevante për t'i hapur rrugë këtyre komuniteteve për integrim të plotë, integrim ky i cili do t'i mundësojë këtyre komuniteteve gjithëpërfshirjen, ruajtjen, promovimin, zhvillimin dhe përparimin e identitetit të tyre, traditës, kulturës.

Integrimi i pjesshëm i komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në arsim

Gjatë analizave të bëra për pozitën e komunitetit rom, ashkali, egjiptian në Kosovë, janë identifikuar faktorët kryesorë të cilët kanë ndikuar në integrimin e pjesshëm të këtyre komuniteteve në shoqëri. Mobilizimi jo i mjaftueshëm i organeve qeveritare, fondet e limituara qeveritare dhe të donatorëve, fushatat e pakta në lidhje me rëndësinë e arsimit, mungesa e iniciativave për të avokuar dhe lobuar për të drejtat e minoriteteve, , janë ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në përfshirjen e pjesshme të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në Kosovë. Me gjithë faktin se pas konfliktit në Kosovë janë ndërmarrë disa iniciativa të ndryshme me qëllim të krijimit të klimës pozitive në klasë dhe në shkollë, pastaj programe stimuluese për motivimin e nxënësve për vijim të rregullt të shkollës, si programe për si zhdukje e analfabetizmit, mësimi i përshpejtuar, programet për arsim joformal dhe kuotimet për rritjen e regjistrimit në arsimin e mesëm dhe universitar, kthimin në bankat shkollore të atyre që kanë braktisur shkollor, vazhdon të m, mbetet shqetësues fakti se numri i fëmijëve të përfshirë në arsimin e nivelit parauniversitar dhe universitar si dhe numri i fëmijëve që braktisin dhe nuk përfundojnë shkollën është shumë i lartë. Statusi i pavolitshëm socio-ekonomik, numri i vogël i edukatorëve dhe mësimdhënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, mungesa e arsimit në gjuhën rome, vështirësitë në zotërimin e gjuhës zyrtare në fillim të shkollimit, si dhe paragjykimet dhe stereotipet karshi këtyre komuniteteve, paraqesin disa nga barrierat tjera të cilat kanë bërë që përfshirja e pjestarëve të këtyre komuniteteve në arsim të vazhdon te mbetet në nivel shumë të ulët

Pjesëmarrje jo e kënaqshme e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në arsim

Niveli i sigurisë së lëvizjes në Kosovë në këto 7-8 vitet e fundit ka bërë që në disa vendbanime fëmijët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian të mos ndihen të sigurtë për të vijuar mësimet në kuadër të sistemit të rregullt arsimor. Kjo ka bërë krijimin e një shërbimi improvizues arsimor, i cili vazhdon të funksionojë në kampe si ai Gjilanit dhe kampi në Plemetin , të cilat funksionojnë në kushte të pavolitshme të punës, në disa komunitete me mësimdhënës të pakualifikuar dhe në kushte shumë të vështira. Niveli i mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë shkolla ka qenë shumë i ulët dhe shpesh here jo në pajtimme sistemin e rregullt arsimor me çka i ka pamundësuar nxënësve transferim në arsimin e rregullt.

Bashkëpunimi i pamjaftueshëm mes MAShT dhe organizatave të shoqërisë civile të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian që merren me çështjet e arsimit ka bërë që autoritetet arsimore të mos jenë të njohura nga afër me vështirësitë dhe problemet me të cilat janë ballafaquar komunitetet, gjë që ka ndikuar në mungesë transparence gjatë marrjes së vendimeve me interes për këto komunitete.

Niveli i varfërisë, konceptet dhe niveli i ulët i arsimimit të prindërve, përfshirja në nivelin jo të duhur në edukimin parashkollor, mungesa e programeve alternative për edukimin e pjesëtareve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian janë faktorë tjerë për mospërfshirjen e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në arsim. Numri i fëmijëve që nuk regjistrohen me kohë, dhe i atyre që e braktisin shkollën është shumë i madh. MASHT dhe OSBE ka disa vite që ofrojnë programe të mësimit intensiv për nxënësit që kanë ndërprerë shkollën. Ky mësim ofrohet si mundësi alternative për vazhdimin dhe përfundimin e arsimit të obliguar. Shumë fëmijë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike detyrohen të ndërpresin shkollën për t`u bërë krahë pune për prindërit e tyre.

Paragjykimet dhe stereotipet e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera etnike ndaj këtyre komuniteteve dukshëm vërehen edhe në sistemin arsimor, që reflekton me diskriminimin që bëhet ndaj nxënësve dhe prindërve të këtyre komuniteteve.

Duke pasur parasysh që arsimimi është kusht i domosdoshëm për konkurrencë në tregun e punës, është e nevojshme që pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali Egjiptian të përfundojnë së paku arsimin fillor dhe të mesëm. Për të arritur këtë gjendje, strategjia parasheh hartimin e politikave mbështetëse siç janë: dhënia e bursave, kuota për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, në mënyrë që të vazhdojnë studimet në fusha të ndryshme. Konkurrenca në tregun e punës kërkon që pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian të jenë të arsimuar dhe të përgatitur profesionalisht për të zënë një vende pune.

Edhe pse Kosova ka legjislacion të veçantë anti-diskriminim ndërkohë që legjislacioni arsimor ndalon të gjitha format e diskriminimit dhe segregimit, megjithatë në praktikë janë të pranishme raste të diskriminimit dhe të segregimit në raport me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian.

3. Vizioni dhe Misioni

Strategjia e Qeverisë së Kosovës për Integrimin dhe Fuqizimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në Kosovë do jetë pjesë integrale e strategjive të tjera zhvillimore të Kosovës të hartuara për vitet 2007-2017. Strategjia e Arsimit Parauniversitar gjithashtu është një dokument që për parim ka zhvillimin e një sistemi arsimor për të gjithë, pa dallim etnik, gjuhësor, racor, kulturor dhe religjioz. Institucionet arsimore në të gjitha nivelet do të jenë faktorët kryesor të cilët do të luajnë rol të pazëvendësueshëm në eliminimin e formave të diskriminimit, segregimit, paragjykimeve dhe jo-tolerancës ndëretnike. Eliminimi i këtyre formave të trajtimit jo të drejtë, ofrimi i mundësive të barabarta për arsimim cilësor dhe respektimi i diversitetit kulturor e gjuhësor nga ana e shumicës, do të kontribuojnë në fuqizimin e pozitës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqëri, si dhe do të hapë rrugë për integrim të plotë të tyre në jetën publike dhe institucionale.

Vizioni

Kosova – shoqëri e dijes dhe gjithëpërfshirëse, me respekt për diversitetin, e integruar në rrjedha evropiane, me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilit i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

Realizimi i këtij vizioni të që buron nga ai i definuar në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2007-2017 në Kosovën e cila ende është duke u përpëlitur me etapën e vështirë të transicionit, të statusit të pazgjidhur politik, me ndasi ndëretnike, nuk do të jetë e lehtë. Në anën tjetër, derisa Kosova përballet me këto probleme, bota lëvizë me një shpejtësi marramendëse drejt një shoqërie dhe ekonomie të bazuar në dije. Natyrisht, Kosova nuk ka vetëm probleme dhe pengesa, ka edhe mundësi dhe lehtësi. Një ndër to është mundësia e krijuar për dije dhe informacion bashkëkohor, bashkë me motivimin dhe aftësimin për përdorimin racional të këtyre burimeve në shërbim të individit dhe të bashkësisë në tërësi. Kjo mundësi e ofruar për të gjithë qytetarët është çelës për zgjidhjen e të gjitha problemeve ekonomike, sociale e politike, sepse individët pavarësisht nga çfarëdo dallimi a interesi që kanë, kanë interes vital për integrimin e Kosovës në shoqërinë e dijes së botës bashkëkohore.

Misioni

Ndërtimi i sistemit arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës, të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin, që i kontribuon integrimit të plotë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqëri.

Përfshirja e qytetarëve në sistemin e arsimit është një ndër treguesit e zhvillimit të një shoqërie, ndërsa në rastin e arsimit të obligueshëm është edhe obligim ndërkombëtar. Barazia nënkupton të qenët i barabartë në status, të kesh mundësi të barabarta, të marrësh një trajtim të barabartë, pa diskriminime, pa barriera dhe pa paragjykime. Ky parim kërkon që të gjithë personave dhe institucioneve të përfshira në arenën e arsimit (si personeli mësimor dhe administrativ, nxënësit, prindërit, komuniteti, grupet e pafavorizuara, shkollat, shoqëria civile, etj.), t'u jepen të drejta të barabarta sipas statusit të tyre, të trajtohen si të barabartë për një zhvillim normal individual dhe institucional dhe për një përmbushje të suksesshme të detyrave dhe të përgjegjësive. Barazia mund të jetë numerike ose proporcionale. Respektimi i barazisë pranohet si një standard minimal i kulturës së sotme morale dhe arsimore, ndërsa ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë është parakusht për sigurimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në jetën shoqërore.

Diversiteti nënkupton diç më shumë se përkatësinë etnike dhe përfshin aspekte si gjuha, mosha, gjinia, përkatësia fetare, statusi shoqëror i qytetarit, ose veçantinë relative të secilit individ në popullatë. Edukimi për njohjen e diversitetit nënkupton kompetenca si: haptësia, të kuptuarit e kulturave tjera, qasje kritike ndaj realitetit shoqëror, niveli i zhvillimit, etj.

4. Objektivat strategjike

Grupi hartues ka identifikuar katër objektiva strategjike që kontribuojnë në arritjen e misionit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në fushën e arsimit. Përmbushja e këtyre objektivave strategjike, njëkohësisht do të kontribuojë edhe në arritjen e qëllimit të Strategjisë së Arsimit të Parauniversitar, i cili ka të bëjë me ndërtimin e një sistemi arsimor dhe gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor të të gjithë individëve, duke kultivuar shprehi të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe vlera të qytetarisë demokratike.

Objektiva 1: Përmirësim domethënës i pjesëmarrjes në arsim dhe i cilësisë së arsimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Objektiva 2: Parandalimi i diskriminimit dhe segregacionit në sistemin e arsimit

Objektiva 3: Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes institucioneve dhe organizatave relevante në funksion të arsimimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjipian

Objektiva 4: Ndërgjegjësimi i komuniteteve dhe palëve me interes për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Nga objektivat e hartuara janë parashikuar masa dhe veprimet që duhet ndërmarrë në mënyrë që pozita e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në fushën e arsimit të përmirësohet. Në vazhdim është bërë një përshkrim i detajuar i objektivave strategjike, treguesve dhe masave për secilën nga objektivat strategjike.

4.1. Përmirësim domethënës i pjesëmarrjes në arsim dhe i cilësisë së arsimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë, grupi i punës ka konsideruar se niveli i ulët i arsimit, shkalla e lartë e analfabetizmit në radhët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian është elementi kryesor për mos-përfshirjen e këtij komuniteti në masën e duhur në jetën politike, sociale dhe ekonomike. Është konsideruar që politikat arsimore duhet të synojnë integrimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, duke siguruar qasje të plotë dhe të barabartë si dhe duke krijuar mekanizma specifik, të cilët trajtojnë në mënyrë të veçantë çështjen e përfshirjes në arsim të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian. Masat e parapara në këtë Strategji për përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim janë në koherencë të plotë edhe me masat dhe aktivitetet që janë paraparë në Strategjinë e Arsimit të Parauniversitar.

TREGUESIT

1. Përfshirja e personelit dhe e fëmijëve në nivelin parafillor dhe parashkollor
2. Numri i shtuar i fëmijëve të regjistruar në klasën e parë
3. Ofrohen lehtësime për fëmijët e kategorive sociale
4. Rritet numri i nxënësve që përfundojnë arsimin fillor, të mesëm dhe universitar
5. Shpërndarja e fëmijëve pa dallime nëpër klasa në të gjitha nivelet
6. Ekzistojnë dhe zbatohen programet që mbështesin arsimin joformal
7. Zhvillohet mësimi në gjuhën rome
8. Shtohet numri i institucioneve parafillore dhe parashkollore
9. Funksionalizohen mekanizmat për zbatim të ligjit mbi arsimin
10. Zyra komunale të komuniteteve të fuqizuara
11. Ekzistojnë dhe zbatohen programe për trajnimin e personelit arsimor për planifikim, menaxhim dhe zhvillim profesional
12. Ekzistojnë rrjete funksionale të organizatave joqeveritare të cilat trajtojnë problemet në fushën e arsimit
13. Ekzistojnë agjensione të cilat merren me ndërtim të kapaciteteve në fushën e arsimit

VEPRIMET

Veprimi 1:	**Përfshirja e edukatorëve rom, ashkali, egjiptian dhe asistentëve të tyre në nivelin parafillor dhe parashkollor**
Përshkrimi:	Aftësohen 90 edukatorë nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian për punë në institucione parafillore dhe parashkollore. Identifikohen edukatorët e ardhshëm nga radhët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, që të përfshihen më shpejt në sistemin arsimor duke iu ofruar subvencione – studim-pune-praktike
Veprimi 2:	**Aftësimi dhe riaftësimi i mësimdhënësve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në shkollimin e obligueshëm**
Përshkrimi:	Mësimdhënësit e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian të cilët ndodhen në procesin arsimor do të marrin trajnime shtesë lidhur me metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mësimdhënësit do të kalojnë në programet pa shkëputje nga puna që ofrohen nga institucionet arsimore. Identifikohen mësimdhënësit e ardhshëm që të përfshihen më shpejt në sistemin arsimor duke iu ofruar subvencione – studim-punë-praktike Organizohen shkolla verore për mësimdhënësit që japin lëndën gjuhën rome. Këto shkolla verore do të jenë të hapura edhe për mësimdhënësit e komuniteteve të tjera. Bëhet shkëmbimi i mësimdhënësve rom, ashkali, egjiptian me qëllim të ngritjes profesionale.
Veprimi 3:	**Ofrimi i programeve reintegruese për fëmijët e kthyer nga diaspora**
Përshkrimi:	Organizohen kurse intensive gjashtë-mujore për gjuhën te fëmijët të cilët kanë jetuar në diasporë. Kurset ofrohen në gjuhën të cilën fëmijët do të vazhdojnë shkollimin e mëtutjeshëm. Këto kurse do të shërbejnë edhe për njohjen e kulturës dhe traditës së vendit. Sipas nevojës, do të organizohet mësimi plotësues.

Veprimi 4:	**Motivimi për pjesëmarrje të shtuar në arsim**
Përshkrimi:	DKA, shkolla dhe OJQ-të bëjnë fushata për regjistrimin e fëmijëve në nivelin parafillor dhe fillor. Krijohen programe për incentiva për motivimin e fëmijëve që të vijojnë me rregull shkollën. Nxënësve me vështirësi në të nxënë u ofrohen orë plotësuese në shkollë ku ata vijojnë mesmin apo në qendrat komunitetit. Këto ore plotësuese do të bëhen për fëmijët me vështirësi në të nxënë dhe ata që janë identifikuar se nuk kanë mbështetje në familje për kryerjen e obligimeve shkollore. Sigurohen fonde për transportim për te gjithë ata fëmijë ne parafillore dhe të ciklit të ulët të cilët udhëtojnë dy kilometra (edhe pse tani për tani është duke u bërë sigurimi i transportit nga DKA per fëmijët që udhëtojnë me shumë se katër kilometra). Sigurimi i transportit për këta fëmijë do të mundësonte vijimin e rregullt dhe qasjen në shkollë.
Veprimi 5:	**Krijimi i kushteve për vazhdimin e e arsimimit pas shkollimit të obligueshëm**
Përshkrimi:	Ofrimi i kurseve përgatitore për nxënësit me sukses të dobët për regjistrim në shkollë të mesme. Themelohet një fond i veçantë për bursa për fëmijët me kushte të vështira ekonomike dhe që tregojnë suksese në mësim me qëllim të përfundimit me sukses të shkollimit. Ky fond do të monitorohet nga DKA dhe zyrat lokale për komunitete. Organizimi i fushatave për ngritjen e vetëdijes për vazhdimin e shkollimit. Krijohet hapësirë për sistemimin nëpër konvikte të nxënësve dhe studentëve udhëtarë që vijojnë mësimin larg vendbanimit të tyre. Kjo do të ndikonte në ngritjen e nivelit të arsimit. MASHT lehtëson regjistrimin e nxënësve dhe studentëve në konvikte.

Veprimi 6:	**Përfshirja e Gjuhës Rome si lëndë mësimore**
Pershkrimi:	MASHT në bashkëpunim me OJQ-të identifikon dhe bën trajnimin e ekspertëve për hartimin e kurrikulit për gjuhën rome. Pas hartimit të kurrikulit bëhet diskutimi publik për vlerësime, sugjerime dhe plotësime etj. Pas këtyre debateve do të bëhet drafti përfundimtar i kurrikulit. Dizajnohen programe trajnimi për mësimdhënësit e gjuhës rome bazuar në kurrikulin e hartuar për gjuhën rome. Këto programe trajnime iu ofrohen pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian të cilët do të punojnë me nxënësit në arsimin e obligueshëm. Po ashtu, në kuadër të planprogrameve të rregullta zhvillohen dhe futen përmbajtje që prezantojnë elemente të traditës, kulturës dhe historisë së komuniteteve rom, ashkali, egjiptian. Mund të zhvillohen edhe programe opcionale për ata që dëshirojnë të thellohen në njohjen e traditës, kulturës dhe historisë së komuniteteve. Këto programe duhet të zhvillohen duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe nevojat për afirmimin e vlerave dhe luftimin e praktikave të dëmshme. Mësimi në gjuhën rome do të organizohet në formë të mësimit zgjedhor varësisht nga koncentrimi i fëmijëve rom, ashkali, egjiptian në shkollë.
Veprimi 7:	**Programe plotësuese gjuhësore për fëmijët nga komuniteti rom**
Përshkrimi:	MASHT harton dhe organizon programe plotësuese, në bashkëpunim me shoqërinë civile, për fëmijët e komunitetit rom në gjuhën në të cilën do të vijojnë mësimin e rregullt duke filluar prej edukimit parashkollor. Pjesëtarë të komunitetit rom ose njohës të gjuhës rome do të aftësohen për organizimin e këtij programi dhe do të bëjnë aftësimin e fëmijëve për t'u integruar më lehtë në sistemin e rregullt arsimor. Këto programe aftësimi do të ofrohen në nivel shkolle dhe nëpër qendra te komunitetit sipas nevojës. Kohëzgjatja e programeve do të jetë adekuate për mësimin e gjuhës së mjedisit. Këto programe duhet të përfshijnë elemente të përgatitjes së fëmijëve për shkollë. Ndërkaq, instruktorët e gjuhës duhet të trajnohen si edukatorë parashkollorë.

Veprimi 8:	**Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt arsimor**
Përshkrimi:	Ofrohen programe vetëdijësuese për prindërit dhe popullatën për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt arsimor. Organizohen aktivitete këshilluese me mundësi aftësimi të prindërve të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara. Sipas mundësisë, organizohen forma të ndryshme të ofrimit të ndihmës fëmijëve me aftësi të kufizuara, përfshirë përcjelljen, etj. Ofrohen incentiva për familjet e fëmijëve me nevoja të veçanta për të motivuar për dërgimin e fëmijëve në shkollë, p.sh. asistencë financiare për familjet, transporti, shujtat, etj.
Veprimi 9:	**Rritja e përfshirjes në arsimin profesional**
Përshkrimi:	Në partneritet me qendrat e aftësimit profesional bëhet hulumtimi i nevojave për arsimim dhe zhvillim profesional të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian. Në bazë të nevojave të identifikuara dhe në bazë të nevojave të tregut hartohen programe dhe bëhet arsimimi profesional për këta pjesëtarë. Njëkohësisht sensibilizohen komunitetet për shfrytëzimin e shërbimeve lidhur me arsimin profesional që ofrohen nga institucionet e ndryshme. Për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian duhet të parashihen kuota për regjistrim në institucione të arsimit profesional.
Veprimi 10:	**Krijimi i skemës së granteve për komunitetet rom, ashkali, egjiptian**
Përshkrimi:	Në skemë të granteve parashihet sigurimi i mjeteve nga qeveria dhe nga donatorët e jashtëm. Në çdo tri vjet do të organizohet konferencë me donatorë. MASHT do të krijojë një njësi që do të merret me menaxhimin e përgjithshëm të këtij fondi. Themelohet skema e granteve për të ofruar financim të projekteve që kanë për qëllim rritjen e pjesëmarrjes në arsim, dhe zvogëlimin e shkallës së analfabetizmit për personat e papërshirë në sistemin shkollor.

	Në skemën e granteve kanë qasje shkollat fillore dhe të mesme që kanë nxënës të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian si dhe OJQ-të që merren me çështjen e arsimit, por që projektet kanë për përfitues nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian. Në planet zhvillimore të shkollave të parashihen programe atraktive për rritje të përfshirjes së nxënësve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian.

SUPOZIMET KRITIKE

Ekziston gatishmëria e institucioneve dhe komuniteteve për gjithëpërfshirjen në arsim

Implementimi i këtij dokumenti varet shumë nga gatishmëria e institucioneve qeveritare për të përkrahur zbatimin e këtij dokumenti. Aprovimi, hartimin i politikave që mundësojnë zbatimin e këtij dokumenti dhe ndarja e fondeve për realizmin e projekteve të veçanta janë hapat kryesor që institucionet duhet të bëjnë për realizmin e Strategjisë për integrimin e Komuniteteve rom, ashkali, egjiptian. Gjithashtu, rol me rëndësi në përfshirjen e pjesëtarëve të komunitetet rom, ashkali, egjiptian në arsim ka edhe përkrahja që do t'i bëhet këtij komuniteti nga popullata shumicë. Toleranca ndëretnike, respektimi i diversitetin dhe të drejtave të njeriut janë kushte themelore që hapin rrugën drejt integrimit të këtij komuniteti në jetë politike, ekonomike dhe shoqërore.

4.2. Parandalimi i diskriminimit dhe segregacionit në sistemin e arsimit

Dukuria e diskriminimit dhe segregacionit në arsim është njëri ndër faktorët pengues për integrimine komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në shoqërinë kosovare. Nuk ka dyshim se ekzistojnë mundësi të shumta për t'u "maskuar" rastet e diskriminimit dhe të segregacionit në sistemin e arsimit, prandaj parakusht me rëndësi për kundërvënie këtyre dukurive është ekzistimi i një disponimi pozitiv nga qana e autoriteteve të arsimit, por edhe ndërgjegjësimi i popullatës shumicë për nevojëne përkrahjes së arsimimit të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian.

TREGUESIT

1. Raportohen dhe bëhen publike rastet e diskriminimit dhe të segregacionit ndaj komuniteteve rom, ashkali, egjiptian
2. Punëtorëte arsimit njohin rëndësinë e parapengimit të dukurisë së diskriminimit dhe segregacionit.
3. Zvogëlohet dukshëm numri i rasteve të diskriminimit dhe të segregacionit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian.

Veprimi 1:	**Analiza e gjendjes lidhur me segregacionin dhe diskriminimin në arsim**
Përshkrimi:	MASHT në partneritet me OJQ-të organizon një hulumtim për praninë e segregacionit dhe diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në sistemin arsimor të Kosovës. Pritet që kjo analizë të sjell një pasqyrë besnike të gjendjes në këtë fushë dhe rekomandime konkrete për veprim.
Veprimi 2:	**Parandalimi i segregacionit dhe diskriminimit me akte ligjore**
Përshkrimi:	Me akte ligjore duhet të parandalohet segregacioni i fëmijëve në shkolla të veçanta, në ndërtesa të veçanta, ose në klasa të veçanta, në baza të përkatësisë etnike, përveç në rastet kur ndarja e fëmijëve bëhet për shkak të vijimit të mësimit në gjuhë të caktuar mësimore ose për shkak të largësisë nga shkollat me nxënësit e komuniteteve shumicë. Normat ligjore duhet të parashikojë masa efektive për parandalimin e segregacionit dhe për desegregacion. Po ashtu, duhet të parashihen masa efektive për pengimin e diskriminimit.
Veprimi 3:	**Trajnime për punëtorë dhe zyrtarë arsimi për eliminimin e paragjykimeve**
Përshkrimi:	Punëtorët dhe zyrtarët e arsimit trajnohen në bazë të programeve të veçanta për eliminimin e paragjykimeve, si dhe në bazë të programeve

	që kanë për bazë qasjen e bazuar në tolerancë ndëretnike dhe ndërkulturore. Qëllimi i këtyre trajnimeve është ndërgjegjësimi për respektimin e diversitetit dhe pengimi i diskriminimit të qëllimshëm ose të paqëllimshëm.
Veprimi 4:	**Ngritja e vetëdijes te komunitetet rom, ashkali, egjiptian për format e diskriminimit dhe segregacionit në arsim**
Përshkrimi:	Duhet të ndërtohet kapaciteti te komunitetet rom, ashkali, egjiptian për njohjen e segregacionit në arsim, dokumentimin dhe veprimet pasuese. Kapacitetet e tilla do të jenë në funksion të minimizimit të diskriminimit dhe segregacionit nga këtyre komuniteteve në sistemin e arsimit.

4.3. Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes organizatave dhe institucioneve relevante

Me qëllim të përmirësimit të pozitës dhe integrimit të plotë të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në shoqëri janë paraparë aktivitete që kontribuojnë në përmirësimin pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në veprimtaritë e institucioneve dhe organizatave relevante arsimore në të gjitha nivelet. Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian do kenë mundësinë të jenë pjesë e hartimit të politikave dhe marrjes së vendimeve me rëndësi që lidhen me çështjet arsimore. Në disa komuna, nëpër Drejtoritë Komunale të Arsimit, do të hapen vende të punës për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian me qëllim të prezantimit të nevojave të këtyre komuniteteve si dhe informimit sa më transparent në lidhje me shërbimet dhe mundësitë që ofrohen për arsimim dhe avancim. Rëndësi shumë e madhe i është kushtuar bashkëpunimit të shkollës dhe komunitetit. Organizimi i aktiviteteve të shumta me karakter arsimor dhe kulturor do t'i mundësojë pjesëtarëve të këtyre komuniteteve të ruajnë dhe promovojnë identitetin e tyre kulturor, gjuhësor, si dhe të krijojnë hapësirë për më shumë siguri dhe tolerancë.

TREGUESIT

1. Rritet bashkëpunimi në mes shkollës dhe prindërve për vetëdijësimin dhe rëndësinë e arsimit tek komunitetet rom, ashkali, egjiptian
2. Mobilizohet shoqëria civile dhe institucionet qeveritare për integrim të plotë të komunitetеteve rom, ashkali, egjiptian në shoqëri
3. Ekziston përfaqësim kompetent në këshillin e shkollës dhe KPA në shkollat ku ka nxënës të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian
4. MASHT krijon kushte të favorshme për arsimimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian

VEPRIMET

Veprimi 1:	**Aktivitete të përbashkëta me policinë e komunitetit lidhur me siguri**
Përshkrimi:	Formohet këshilli i sigurisë në nivelin komunal për siguri. Ky këshill përbëhet nga përfaqësuesit e DKA, PK, përfaqësuesi i shkollës, Këshilli i shkollës dhe përfaqësuesi i komunitetit apo OJQ-ve rom, ashkali, egjiptian. Ky këshill do të organizojë takime të përbashkëta çdo dy muaj në mes të komunitetit dhe policisë së komunitetit për siguri në mënyrë që të rritet shkalla e sigurisë në ato shkolla ku gravitojnë fëmijët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian. Komuniteti, fëmijët dhe policia e komunitetit, në bashkëpunim me DKA do të jenë prezent në takimet e përbashkëta që do të organizohen nëpër shkolla. Në çdo dy muaj do të publikohen raportet.
Veprimi 2:	**Masat për mosrespektim të ligjit mbi shkollimin e obliguar**
Përshkrimi:	Do të merren masa për vendosjen e bashkëpunimi të ngushtë në mes të autoriteteve të arsimit, shkollave dhe qendrave për punë sociale dhe organizatave të shoqërise civile me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të mosvijueshmërisë dhe braktisjes. Duhet të ekzistojë një sistem i raportimit për rastet e tilla, sistem ky i cili duhet të vendoset mes Qendrës për Punë sociale, DKA-së dhe zyrave të ofiqarisë, ku

	kontribut të madh do të luajnë edhe raportet që bëhen nga organizatat nga shoqëria civile e komunitetit rom, ashkali, egjiptian. Gjithashtu në rastet e braktisjes së shkollimit jo të rregullt ose mosvijimit duhet ndërmarrë masa ndaj mësimdhënësve dhe autoriteteve shkollore për mosraportimin e këtyre rasteve dhe mos-ndërmarrjen e veprimeve për t'i kthyer në shkollë. KPA do të bëjë monitorimin e shkollave për t'u siguruar se pjesëmarrja e përfaqësuesve të komunitetit rom, ashkali, egjiptian është përgjegjësi e organeve ë qeverisëse të shkollës. Gjithashtu, KPA siguron se rastet e mosrespektimit të ligjit për arsimin e obliguar janë raportuar në nivel shkolle, komune dhe MAShT.
Veprimi 3:	**Koordinimi i politikave dhe aktiviteteve përmes takimeve të rregullta të MASHT, organeve komunale,DKA-së me organizatat e shoqërisë civile**
Përshkrimi:	Përfaqësuesit e prindërve, komuniteteve dhe te të organizatave të shoqërisë civile rom, ashkali, egjiptian do të marrin pjesë në takimet DKA dhe MASHT ku hartohen politika të rëndësishme dhe merren vendime lidhur me procesin arsimor Me anë të koordinimit vihen në pah: informimi me kohë, transparenca në marrjen e vendimeve të rëndësishme që lidhen me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian. DKA në bashkëpunim me ZKK dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërise civile hartojnë së bashku planin zhvillimor me prioritete trevjeçare në fushën e arsimit. Në këtë plan pasqyrohen nevojat e komunitetit rom, ashkali, egjiptian. Përgjegjës për zbatimin e këtij plani është DKA dhe ZKK.
Veprimi 4:	**Ndërtohet partneritet në mes të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian me institucionet dhe organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit**
Përshkrimi:	Me qëllim të prezantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve të

	arsimit nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian, organizohen aktivitete me qëllim të informimit lidhur me veprimtarinë e institucioneve dhe organizatave të tilla dhe vendoset bashkëpunimi me to. Identifikohen rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe bëhet raportimi me kohë i rasteve të shkeljes së të drejtave të punëtorëve.
Veprimi 5:	**Ndërmarrja e veprimeve afirmative për shkollim dhe punësim të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian**
Përshkrimi:	|Shkolla organizon orë shtesë për nxënësit që kanë vështirësi në mësinxënie. Identifikohen profilet deficitare të rëndësishme për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian. Lehtësohet regjistrimi në shkolla të mesme dhe fakultet për ata nxënës të cilët nuk kanë treguar sukses të mjaftueshëm në shkollimin fillor dhe të mesëm. Për këtë kategori do të ofrohen kurse përgatitore për regjistrim në shkollimin e mesëm dhe universitar. Caktohen kuota për regjistrimin e nxënësve në shkolla të mesme dhe fakultete. Për nxënësit të cilët regjistrohen ndahen bursa me qëllim të stimulimit të tyre për vazhdim të shkollimit. Organizohen takime nga DKA për informimin e nxënësve dhe studentëve në lidhje me mundësitë e shkollimit. MASHT/DKA/ZRA krijojnë kuota (rezervon vende pune për komunitetin rom, ashkali, egjiptian) për pranimin e personelit arsimor në sistemin e arsimit.
Veprimi 6:	**Ofrohen programe ekzistuese për zvogëlimin e shkallës së analfabetizmit - përkrahje institucionale**
